



Demokracia në Veprim
Demokratija na Delu
Democracy in Action

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR
KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

2017





DEMOKRACIA NË VEPRIM
DEMOKRATIJA NA DELU
DEMOCRACY IN ACTION

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës

11 qershor 2017

RAPORTI I VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

Copyright ©2017. Demokracia në Veprim (DnV).

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me mbështetjen e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Zyrës Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K), Agjencisë Daneze për Zhvillim Ndërkombëtar (DANIDA), Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore - Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Demokracisë në Veprim dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e donatorëve.

Demokracia në Veprim

Rruga "Bajram Kelmendi" nr. 45

10 000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 248 038

www.demokracianeveprim.org

PËRMBAJTJA

Përmbledhje ekzekutive.....	5
I. Hyrje.....	7
II. Konteksti politik	9
III. Korniza ligjore	10
A. Legjislacioni primar dhe sekondar	10
B. Sistemi zgjedhor dhe shpërndarja e ulëseve	12
IV. Administrimi i zgjedhjeve.....	12
A. Shpallja e zgjedhjeve.....	12
B. Administrimi i zgjedhjeve.....	13
i. Puna e KQZ-së	13
ii. Funksionimi e KKZ-ve	13
iii. Trajnimi i KVV-ve.....	13
iv. Edukimi dhe informimi i votuesve	14
V. Certifikimi i listës së votuesve.....	14
VI. Votimi nga jashtë	14
VII. Regjistrimi dhe certifikimi i kandidatëve	15
VIII. Fushata zgjedhore.....	15
C. Ambienti i fushatës zgjedhore	15
D. Shfrytëzimi i resurseve publike dhe pjesëmarrja e shërbyesve civil në aktivitete elektorale ..	16
E. Prania e fëmijëve	17
F. Pjesëmarrja e grave	17
G. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në fushatë.....	19
H. Fushata zgjedhore në rrjetet sociale.....	19
IX. Drejtësia zgjedhore	20
X. Vëzhgimi i zgjedhjeve.....	22
XI. Votimi.....	23
A. Hapja e vendvotimeve	23
B. Fushata në ditën e zgjedhjeve	24
Prania e materialeve propaganduese jashtë Qendrave të Votimit	24
Propaganda politike brenda Vendvotimit.....	25
C. Zbatimi i procedurave të votimit	25
D. Fshehtësia e votës.....	26
Votimi në grup (familjar).....	26
Asistenca e votuesve.....	26

Fotografimi i fletëvotimit	27
Votimi jashtë kabinave të votimit	28
E. Tentimi për të votuar më shumë se njëherë dhe votimet e dyfishta	29
F. Parregullsi tjera gjatë votimit.....	29
Prania e personave të paautorizuar.....	30
Dhunë apo kërcënime në Vendvotime	30
G. Lista e votuesve.....	30
XII. Numërimi dhe certifikimi i rezultateve	30
H. Procedurat e numërimit.....	30
I. Votat e pavlefshme	31
XIII. Dalja në zgjedhje	32
XIV. Rekomandimet.....	34
Shtojca 1: Rezultatet e zgjedhjeve për subjektet politike.....	37

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zgjedhjet e 11 qershorit 2017 kanë qenë të qeta dhe nuk janë shënuar shkelje të rënda dhe veprime të dhunshme, të cilat do të dobësonin besimin e publikut në procesin zgjedhor. Përjashtim bën periudha e fushatës zgjedhore në komunat me shumicë serbe, ku atmosfera e fushatës ka qenë e tensionuar dhe votuesit janë ndjerë të frikësuar. Në këto komuna, dita e zgjedhjeve ka qenë e mbikëqyrur nga forca të shtuara të sigurisë.

Dita e Zgjedhjeve në përgjithësi ka kaluar pa incidente serioze, megjithatë vëzhguesit tanë kanë regjistruar disa parregullsi gjatë votimit, siç janë: i) Cenimi i fshehtësisë së votimit që është shprehur përmes votimit familjar, rasteve kur i njëjti person ka asistuar më shumë se njëherë si dhe votimi jashtë kabinave të votimit. ii) Dyshimi për krijim të varësisë ekonomike ndaj votuesve është shprehur përmes fotografimit të fletëvotimit. iii) Keqpërdorim i së drejtës së votimit është shprehur përmes tentimit për të votuar më shumë se njëherë. iv) Presioni i mundshëm ndaj votuesve përmes pranisë së personave të paautorizuar në qendrat e votimit apo vendvotime, i cili ka qenë më i theksuar në orët e paradites. v) Privimi i së drejtës së votimit për personat me aftësi të kufizuar për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate për qasje në të gjitha vendvotimet.

Pasaktësia e listës së votuesve vazhdon të mbetet element negativ i të gjitha proceseve zgjedhore në Kosovë duke përfshirë edhe zgjedhjet e 11 qershorit 2017. Përkundër disa përpjekjeve institucionale për ta pastruar listën e votuesve nga personat e vdekur, janë raportuar raste kur emrat e tyre vazhdojnë të figurojnë në këtë listë.

Votuesit nga jashtë kanë hasur në vështirësi gjatë procesit për regjistrim për votim me postë. Fushata e informimit të votuesve nga jashtë ka filluar shumë vonë dhe nuk ka ofruar udhëzime të mjaftueshme. KQZ nuk ka qenë e përgatitur për t'u përballuar numrin e madh të aplikimeve elektronike, që është manifestuar me dështim të serverëve dhe si rrjedhojë votuesve ju është pamundësuar e drejta e votës. Reforma zgjedhore duhet të adresojë këtë problem duke eliminuar barrierat e panevojshme dhe thjeshtësuar procedurat e votimit.

Numri i lartë i fletëvotimeve të pavlefshme është shqetësues. Për më tepër, ka trend të rritjes së këtyre fletëvotimeve, përkundër faktit që sistemi zgjedhor ka mbetur i njëjtë. KQZ duhet që sa më parë të bëjë hulumtimin dhe analizimin e shkaqeve që kanë çuar në rritjen e numrit të këtyre fletëvotimeve të pavlefshme. DNV thërret organet përgjegjëse që të ndërmerren masat e nevojshme për t'i adresuar më seriozisht problemet e identifikuar. Mbi të gjitha, KQZ duhet të bëjë përpjekje të shtuara për të edukuar dhe informuar votuesit për mënyrën e votimit, me qëllim të zvogëlimit të votave të pavlefshme.

Fenomen i ri në këto zgjedhje ka qenë akreditimi i një organizate joqeveritare e cila nuk figuronte si tatimpagues aktiv dhe nuk kishte përvojë në vëzhgimin e zgjedhjeve. Numri i madh i vëzhguesve të akredituar nga kjo organizatë ka ngritur dyshime për mision e saj dhe afërsinë e mundshme me ndonjë subjekt të caktuar politik.

Burimet e financimit dhe transparencja financiare e subjekteve politike vazhdon të mbetet problematike prandaj duhet të përmirësohen mekanizmat aktual mbikëqyrës me fokus të veçantë në respektimin e kufizimeve për këtë fushatë zgjedhore të përcaktuara nga KQZ.

DnV vlerëson aktivitetin dhe përpjekjet e komisionerëve në kryerjen e detyrave të tyre duke pasur parasysh afatet e shkurtra për përgatitje. Megjithatë, KQZ nuk ka ofruar trajnime adekuata për komisionarët të cilët në disa raste nuk kanë qenë mirë të informuar me procedurat e votimit, numërimit dhe plotësimit të Formularëve të Përputhjes së Rezultateve. KQZ ka qenë transparente në mbledhjet e mbajtura., por vëzhguesit kanë raportuar për mungesë të qasjes në materialet e shqyrtuara gjatë mbledhjeve të KQZ dhe publikimin me vonesë të vendimeve.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka vepruar me profesionalizëm dhe në mënyrë të paanshme në trajtimin e ankesave, duke respektuar afatet kohore.

Periodha e fushatës zgjedhore ka qenë shumë intensive, me aktivitete të shumta të kandidatëve, në të cilat janë evidentuar parregullsi të ndryshme si: i) përdorimi i fëmijëve në fushatë zgjedhore, në raste të caktuara edhe në mënyrë të organizuar; ii) shfrytëzimi i veturave zyrtare gjatë aktiviteteve të fushatës dhe prani të shërbyesve civil; iii) vendosja e materialeve propaganduese të kandidatëve dhe subjekteve politike në shenja të komunikacionit, shtylla elektrike dhe hapësira tjera publike të cilat nuk janë të destinuara për këtë qëllim; iv) në raste të caktuara, prania e gjuhës së urrejtjes gjatë fushatës; v) pjesëmarrja e ulët e grave në aktivitetet e fushatës së subjekteve politike ofrimi i mundësive jo të barabarta për gratë kandidate për të shpалosur pikëpamjet e tyre. vi) mungesa e qasjes për personat me aftësi të kufizuara në shumë tubime zgjedhore.

Në komunat me shumicë serbe, atmosfera gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ka qenë e tensionuar dhe votuesit shpeshherë janë ndier të frikësuar dhe nën presion për të votuar për një subjekt të caktuar politik.

Prania e mediave në tubimet e fushatës zgjedhore ka qenë e kënaqshme dhe të njëjtit nuk janë penguar për të raportuar lirshëm. Mospjesëmarrja në debate televizive e përfaqësuesve nga të gjitha subjektet politike i ka privuar qytetarët nga e drejta e ballafaqimit të drejtpërdrejtë të kandidatëve dhe ideve si dhe shpалosjen e programeve qeverisëse. Janë të papranueshme përpjekjet e disa subjekteve politike për të ndërhyrë në politikat redaktuese të mediave.

I. HYRJE

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare tashmë janë shndërruar në dukuri normale në Kosovë. Mandati katërvjeçar i Kuvendit asnjëherë nuk u arrit të përmbyllet deri në fund. Shpërndarja e Kuvendit para këtij afati dhe organizimi i zgjedhjeve të parakohshme, brenda afateve minimale prej tridhjetë ditësh është sfiduese për institucionet përgjegjëse për organizimin dhe menaxhimin e zgjedhjeve. Si pasojë, procesi zgjedhor po pëson në cilësi.

Nga një cikël zgjedhor në tjetrin, sfidat kryesore mbesin pothuajse të njëjta. Ndër më të shprehurat në këto zgjedhje ishin:

- Numri në rritje i fletëvotimeve të pavlefshme;
- Fillimi me vonesë i fushatës për informim dhe edukim të votuesve;
- Trajnimet e dobëta të anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve;
- Problemet teknike në regjistrimin e votuesve nga jashtë;
- Listat e pasaktë e votuesve dhe prania evidente e personave të vdekur;
- Frikësim dhe ushtrim i presionit ndaj votuesve nga përfaqësues të komunitetit të njëjtë, i raportuar në komunat me shumicë serbe;
- Përdorimi i resurseve publike për qëllime të fushatës zgjedhore;
- Prania e fëmijëve në fushatë dhe numri i ulët i grave në aktivitetet zgjedhore e TMZ;
- Cenimi i fshehtësisë së votës (përmes fotografimit të fletëvotimit, votimit jashtë kabinës së votimit, votimit në grup apo të njohur si votim familjar);
- Asistimi i votuesve duke mos respektuar procedurat për regjistrim në librin e votimit;
- Shkeljet e shpeshta të Kodit të mirësjelljes nga subjektet politike, përmes vendosjes së materialeve të fushatës zgjedhore në hapësira publike;
- Hezitimi i subjekteve politike për të deklaruar planifikimet dhe shpenzimet për fushatë;
- Vonesat në certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve;
- Numri i madh i kutive të votimit në karantinë për verifikim;
- Akreditimi i vëzhguesve të subjekteve politike përmes OJQ-ve fiktive.

Shumë prej problemeve të identifikuar gjatë procesit zgjedhor do të mund të evitoheshin përmes ndryshimeve në legjislacionin sekondar, praktikave nga ana e KQZ-së dhe e subjekteve politike, fushatave më cilësore të edukimit dhe rritjes së nivelit të përfaqësimit në KVV. Reforma e munguar zgjedhore, e nisur para gjashtë viteve, do të kishte efekt më të madh si në përfaqësimin më të drejtë të qytetarëve ashtu edhe në procesin e administrimit të zgjedhjeve.

Ndër aspektet pozitive të organizimit të zgjedhjeve duhet veçuar:

- Koordinimin e mirë ndërmjet institucioneve shtetërore në ditën e zgjedhjeve (KQZ, Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit) që ka ndikuar në rregullsinë e procesit;
- Efikasitetin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në shqyrtimin e ankesave dhe shqiptimin e gjobave;
- Fushata zgjedhore përgjithësisht e përmbajtur nga gjuha e urrejtjes dhe pa incidente;
- Pranimi i rezultateve të zgjedhjeve nga subjektet politike dhe kandidatët e tyre, që është tregues i nivelit të larë të besimit në proces.

Metodologjia

Demokracia në Veprim, si koalicion i organizatave vendore për vëzhgimin e zgjedhjeve, që nga viti 2007 mbetet i përkushtuar në rritjen e integritetit të zgjedhjeve përmes vëzhgimit të gjithë procesit zgjedhor. Objektivi ynë i përgjithshëm është që të kontribuojmë në promovimin e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të besueshme në një atmosferë paqësore dhe të qëndrueshme. Objektivat specifike përfshijnë:

- Vëzhgimin e zgjedhjeve në mënyrë profesionale dhe të paanshme, për të ndikuar në rritjen e integritetit të zgjedhjeve dhe besueshmërisë së publikut në këtë proces;
- Edukimin dhe informimin e votuesve për mënyrën e votimit dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në zgjedhje të lira pa frikësime apo dhunë;
- Eliminimin e barrierave për pjesëmarrje në zgjedhje nga të gjitha grupet e shoqërisë, duke garantuar mundësi të barabarta, barazi gjinore dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut;
- Vlerësimin e legjitimitetit të procesit zgjedhor në raport me përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe respektimin e kornizës ligjore vendore;
- Ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e mëtejshëm të sistemit dhe administrimit të zgjedhjeve.

Monitorimi i fushatës zgjedhore është mbuluar nga 61 vëzhgues afatgjatë të DnV-së, të cilët për dhjetë ditët e fushatës kanë përcjellur aktivitetet subjekteve politike. Vëzhguesit tanë kanë dhënë vlerësimet për gjuhën e përdorur në tubime, për përfaqësimin e grave në fushatë, si pjesëmarrëse në tubime apo kandidatë të subjekteve politike. Përfshirja e fëmijëve në fushatë në mënyrë të organizuar, shfrytëzimi i resurseve publike, prania e shërbyesve civilë, pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara dhe qasja e tyre në vendet ku janë organizuar aktivitete kanë qenë pjesë e vlerësimit të përditshëm. Të dhënat e grumbulluar janë analizuar nga një ekip i veçantë i specializuar në këtë fushë. Vëzhguesit e DnV-së kanë përcjellë edhe takimet e trupave për menaxhimin të zgjedhjeve, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Në ditën e zgjedhjeve, të mbajtura më 11 qershor 2017, DnV ka angazhuar rreth 2,500 vëzhgues afatshkurtër të zgjedhjeve, të cilët janë shpërndarë në të gjitha vendvotimet në Kosovë. Vëzhguesit kanë raportuar në tri intervale të rregullta kohore lidhur me ecurinë e zgjedhjeve, ndërsa të dhënat janë përpunuar dhe analizuar në Qendrën e Thirrjeve të DnV-së, prej të cilave janë përgatitur njoftimet për publikun.

II. KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës erdhën si rrjedhojë e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, të iniciuar nga Nisma për Kosovën dhe të mbështetur nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Lëvizja “Vetëvendosje” si dhe disa deputetë nga koalicioni qeverisës dhe partitë nga komunitetet jo shumicë, duke çuar në 78 numrin e deputetëve që votuan për mocionin.

Me datën 10 maj 2017, në Kuvendin e Kosovës, u mbajt seanca plenare për shqyrtimin e mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës. Të pranishëm në seancë ishin 117 deputetë, nga të cilët 78 votuan për, 34 ishin kundër dhe 3 deputetë abstenuan. Mocioni për mosbesimin e Qeverisë u mbështet edhe nga deputetët e PDK-së, e cila ishte partner qeverisës i LDK-së. Votat e deputetëve të PDK-së për mocionin e mosbesimit ndaj Qeverisë u nënkuptuan edhe si vendim për prishjen e koalicionit me LDK-në.

Shkarkimit të Qeverisë, në fakt i kishin paraprirë një sërë problemesh e luhatjesh, evidente që nga dita e parë e punës së saj. Zgjedhjet e 8 qershorit të vitit 2014 u pasuan me një bllokadë politike gjashtë-mujore, pasi që partitë parlamentare shqiptare refuzonin të lidhnin koalicion me PDK-në, parti e cila doli e para në ato zgjedhje. I ashtuquajtur “Bllok Opozitar”, i përbërë nga LDK, VV, AAK e Nisma, pushoj së ekzistuari në dhjetor të vitit 2014, kur LDK hyri në koalicion me PDK-në, për të bashkëqeverisur në mandatin e radhës. Koalicioni mes PDK-së dhe LDK-së u zyrtarizua me 19 dhjetor 2016, mirëpo u kundërshtua ashpër edhe nga disa deputetë të LDK-së të cilët votuan kundër Qeverisë që do të udhëhiqej nga shefi i partisë të cilën ata e përfaqësonin.

Gushti i vitit 2015 paraqet një periudhë kyçe të Qeverisë në ikje, pasi që gjatë këtij muaji Qeveria e Republikës së Kosovës nënshkroi dy marrëveshje të cilat më pas u shndërruan në temat kryesore të diskursit publik të skenës politike kosovare. Fillimisht, Kryeministri Isa Mustafa nënshkroi në Bruksel Marrëveshjen për Themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe (AKS), kurse një ditë më vonë, ish-ministri i Jashtëm Hashim Thaçi nënshkroi në Vjenë Marrëveshjen për Demarkacionin e kufirit mes Kosovës dhe Malit të Zi. Të dyja marrëveshjet u nënshkruan përderisa Kuvendi i Republikës së Kosovës ishte zyrtarisht në pushim vjetor dhe ngjalli reagim të menjëhershëm të partive opozitare dhe eksponentëve brenda koalicionit qeverisës. Kundërshtimi i fuqishëm i të dyja marrëveshjeve bazohet në arsyetimin se themelimi i ASK-së krijon parakushte për krijimin e një shteti paralel serb brenda vendit, kurse me formën e nënshkruar të demarkacionit me Malin e Zi, Kosova humbë mbi 8.000 hektarë të territorit të saj. Kundërshtimi i opozitës për dy marrëveshjet e nënshkruara nga Qeveria tejkaloj mekanizmat parlamentar të parapara me Kushtetutën e vendit dhe Rregulloren e Punës së Kuvendit. Përdorimi i gazit lotsjellës, gjuajtja me vezë, hedhja e “koktelit të Molotovit” dhe përleshjet fizike me policinë brenda Kuvendit ishin vetëm disa nga metodat e opozitës për të shprehur kundërshtimin e tyre ndaj marrëveshjeve për ASK-në dhe Demarkacionin me Malin e Zi.

Legjislatura e pestë e Kuvendit të Kosovës vazhdimisht u karakterizua me efikasitet të ultët të punës dhe agjenda legjislative asnjëherë nuk arriti të përmbushej mbi 36%. Kjo legjislature gjithashtu do të mbahet në mend për numër të madh të mungesave të deputetëve, qoftë në seanca plenare ashtu edhe në mbledhjet e komisioneve parlamentare, numrin e ulët të ligjeve të mbikëqyrura. Shpeshherë edhe brenda koalicionit qeverisës kishte mungesë koordinimi dhe qëndrime të kundërta rreth çështjeve të caktuara.

Problemet e theksuara rreth zbatimit të marrëveshjes për themelimin e Asociacionit, dështimi për ratifikimin e marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi si dhe probleme tjera të qytetarëve të vendit të cilat mbeten të pa adresuara në Kuvend sollën mocionin e opozitës që u përkrah edhe nga parteri i koalicionit, PDK.

Presidenti i Republikës së Kosovës me dekret shpërndau Kuvendin e Kosovës dhe caktoi 11 qershorin si datën e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

III. KORNIZA LIGJORE

A. Legjislacioni primar dhe sekondar

Korniza ligjore e cila rregullon organizimin e procesit zgjedhor në Kosovë përbëhet nga Kushtetuta e Kosovës, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligji për Zgjedhjet Lokale, Ligji për Financimin e Subjekteve Politike si dhe Kodi Penal i Republikës së Kosovës. Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) si organ menaxhues i zgjedhjeve po ashtu ka miratuar Rregullat zgjedhore të cilat shërbejnë për të rregulluar aspekte specifike të procesit zgjedhor.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës¹ është ligji më i rëndësishëm i cili rregullon procesin zgjedhor në vend. Ky ligj rregullon sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës; njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar dhe kriteret për pranueshmërinë e votës; mirëmbajtjen e listës së votuesve; regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike; përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; krijimin dhe funksionimin e Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia; organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe këshillave të zgjedhjeve; rregullat për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre; kufizimet e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikim financiar; mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat; kodin e mirësjelljes së subjekteve politike, kandidatëve të tyre dhe mbështetësve; procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve si dhe aspekte tjera të rëndësishme lidhur me zgjedhjet dhe procesin zgjedhor në Kosovë.

Ligj tjetër i rëndësishëm lidhur me procesin zgjedhor në vend është edhe Ligji për Zgjedhjet Lokale². Qëllimi i këtij ligji është organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve për Kuvendet e Komunave dhe Kryetarët e Komunave të Kosovës, ku ndër të tjera përcakton edhe mandatin e Kuvendeve të Komunave dhe të Kryetarëve të Komunave, shpërndarjen e ulëseve për asamblatë komunale, regjistrimin dhe certifikimin e kandidatëve etj.

Një nga ligjet më të rëndësishëm lidhur me zgjedhjet, më konkretisht me shpenzimet e subjekteve politike dhe fushatës parazgjedhore është Ligji për Financimin e Subjekteve Politike.³ Ky ligj rregullon mënyrën, kushtet e financimit, administrimin, mbikëqyrjen, transparencën dhe raportimin për

¹ Gazeta Zyrtare – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544> (qasur me 11.07.2017)

² Gazeta Zyrtare – Ligji për Zgjedhjet Lokale: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2549> (qasur me 11.07.2017)

³ Gazeta Zyrtare – Ligji për Financimin e Subjekteve Politike: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2705> (qasur me 11.07.2017)

shpenzimin e pasurisë dhe të ardhurave të subjekteve politike në Republikën e Kosovës. Më konkretisht, përmes këtij Ligji specifikohen në detaje çështje të rëndësishme sa i përket financave dhe shpenzimeve të subjekteve politike, përfshirë këtu edhe kohën e zgjedhjeve. Ndër specifikat kryesore të këtij ligji janë rregullimi i aspekteve rreth statusit të subjektit politik, burimet financiare dhe materiale të subjekteve, forma për kontributet për subjektet politike, fondi për mbështetjen e subjekteve politike që alokohet nga buxheti i shtetit dhe të ngjashme.

Në veçanti, ky ligji rregullon edhe ndarjen e mjeteve financiare për fushatat zgjedhore. Sipas nenit 10 të këtij ligji, për financimin e fushatës zgjedhore qendrore dhe lokale, për zgjedhje të rregullta dhe të jashtëzakonshme, Kuvendi, nga Fondi, ndan mjete me propozim të Qeverisë por jo më shumë se 0.05% të buxhetit të Kosovës. Mjetet për financimin e fushatës para zgjedhore ndahen për subjektet politike të cilat marrin pjesë në zgjedhje në bazë të kriterit ku 90% e mjeteve financiare ndahen në bazë të numrit të vendeve në Kuvend kurse 10% e mjeteve financiare ndahen proporcionalisht për subjektet politike të posa regjistruara dhe të certifikuara për zgjedhjet nga KQZ-ja.

Duke synuar parandalimin e manipulimeve dhe keqpërdorimeve gjatë procesit zgjedhor, Kodi Penal i Kosovës rregullon me një kapitull të veçantë veprat penale kundër të drejtave të votimit. Në 11 nene, në këtë Kod janë paraparë të gjitha veprat që me ligj sanksionojnë dënimet për kryerësit e krimeve gjatë zgjedhjeve.⁴ Disa nga veprat penale të parapara me Kodin Penal, e që lidhen me procesin zgjedhor janë ndalimi ose pengimi i personit nga kandidimi në zgjedhje; pengimi i kandidatit nga aktivitetet e fushatës; pengimi i votuesit gjatë votimit ose ndikimi në zgjedhjen e tyre; shpërdorimi i pozitës zyrtare të stafit zgjedhor; marrja ose dhënia e ryshfetit në lidhje me votimin; ndërmjetësimi i ryshfetit në lidhje me votimin; votimi ose tentativa për të votuar në emër të dikujt tjetër, më shumë se një herë, dhe/ose duke e përdorur më shumë se një listë të votuesve; pengimi ose ndalimi i paligjshëm i procesit të votimit; shkelja e privatësisë në votim; falsifikimi i rezultateve; dëmtimi i dokumenteve të votimit etj. Shkeljet e këtyre të drejtave penalizohen me gjobë ose me burgim efektiv, ku ndër të tjera parashihen edhe dënime të rënda penale deri në 5 vite burgim si dhe parashikim të dispozitave për konfiskim të dobisë pasurore të përfituar nga vepra të tilla penale. Qëllimi i këtyre dispozitave është që me çdo kusht të mbrohet vota e lirë e qytetarit. Është karakteristike se në Kodin Penal janë përfshirë të gjitha veprat të cilat mund të kryhen para, gjatë dhe pas ditës së zgjedhjeve, duke mos u fokusuar vetëm në ndjekjen dhe dënimin e kryesve të këtyre veprave por duke ndikuar edhe në parandalimin e tyre.

Përveç legjisllacionit primar, procesi zgjedhor në vend është i rregulluar edhe me legjisllacion sekondar. Më konkretisht, KQZ ka miratuar një numër të konsiderueshëm të të ashtuquajturave “Rregulla zgjedhore”, me anë të së cilave rregullohen apskete të caktuara të procesit zgjedhor. Disa nga Rregullat kryesore të miratuara nga KQZ janë: Rregulla nr. 19/2016 për Këshillat e Vendvotimeve; Rregulla nr. 18/2016 për Emërimin, Përbërjen dhe Funkcionimin e Komisioneve Komunale Zgjedhore; Rregulla nr. 03/2013 mbi Votimim jashtë Kosovës; Rregulla nr. 01/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike; Rregulla nr. 08/2013 mbi certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve të tyre; Rregulla nr.12/2013 mbi kufizimin e shpenzimeve të fushatës dhe deklarimi financiar; Rregulla nr. 02/2013 mbi krijimin, konfirmimin dhe kundërshtimin e listës së votuesve; Rregulla nr. 04/2013 mbi votimin e personave me nevoja dhe rrethana të veçanta; Rregulla nr. 05/2013 mbi kutitë postare dhe

⁴ Gazeta Zyrtare – Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Nenet 210 – 220. Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2834> (qasur me 11.07.2017)

komunikimi elektronik me subjektet politike; Rregulla nr. 06/2013 për Qendra e numërimit dhe e rezultateve; Rregulla nr. 07/2013 për vëzhguesit e zgjedhjeve etj.

B. Sistemi zgjedhor dhe shpërndarja e ulëseve

Sistemi zgjedhor në Republikën e Kosovës është i përcaktuar me Kushtetutën e vendit dhe i definuar me ligje specifike. Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e asociimit si dhe të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Republika e Kosovës aplikon sistem zgjedhor proporcional me listë të hapur, ku votohet një subjekt politik dhe deri 5 kandidatë për deputetë nga i njëjti subjekt politik. Kosova nuk është e ndarë në zona zgjedhore, rrjedhimisht ekziston vetëm një zonë zgjedhore e cila u mundëson votuesve të zgjedhin të votojnë për cilindo kandidat, pavarësisht përkatësisë gjeografike të kandidatit.

Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë, nga të cilat 20 vende janë të garantuara për përfaqësim të komuniteteve që janë jo shumicë në Kosovë. Nga 20 vendet e garantuara, 10 prej tyre u takojnë pjesëtarëve nga komunitetit serb, kurse 10 të tjera janë të garantuara për pjesëtarët e komuniteteve tjera.

Republika e Kosovës aplikon prag zgjedhor prej 5% për subjektet politike, koalicionet dhe kandidatët e pavarur për të pasur të drejtën për përfaqësim në Kuvend. Subjektet politike që përfaqësojnë komunitetet joshumicë nuk i nënshtrohen pragut zgjedhor.

Kuota gjinore parashihet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, e cilat përcakton që në listat e kandidatëve të secilit subjekt politik duhet të jenë së paku 30% kandidatë të gjinisë më pak të përfaqësuar. I njëjti kriter aplikohet edhe sa i përket shpërndarjes së vendeve në Kuvend, ku së paku duhet të jenë 30% nga gjinia më pak e përfaqësuar. Deputetë zgjedhën për mandat katër vjeçar.

IV. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

A. Shpallja e zgjedhjeve

Inicimi i mocionit të mosbesimit ndaj Qeverisë, nga subjektet politike opozitare dhe mbështetur nga disa prej deputetëve të subjekteve politike në pushtet, u arsyetua me humbjen e fuqisë në vendimmarrje nga ana e Qeverisë dhe ngecjeve në shtyrjen përpara të disa prej çështjeve të rëndësishme. Deri në moment të fundit, kryeministri Mustafa shpresonte që mocioni nuk do të mbështetet nga partneri i tij i koalicionit, PDK, me të cilin, në marrëveshjen për bashkëqeverisje e kishin vendosur edhe një pikë të veçantë në të cilën thuhej se nuk do të mbështeteshin mocionet e ngritura nga palët e treta. Sidoqoftë, mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë u votua edhe nga deputetët e PDK-së, duke i dhënë fund mandatit të Qeverisë Mustafa. Vendimi për shpërndarjen e Kuvendit u shpall po atë ditë nga ana e Presidentit Thaçi.

Data e mbajtjes së zgjedhjeve të parakohshëm u caktua 11 qershori, duke i dhënë KQZ-së, si institucion përgjegjës, një afat kohor prej 30 ditësh për organizimin dhe mbajtjen e këtyre zgjedhjeve. Meqë zgjedhjet nuk mund të mbahen më herët se 30 dhe më vonë se 45 ditë nga dita e shpërndarjes së Kuvendit, pritjet ishin se do të shfrytëzoheshin afatet maksimale për t'i dhënë KQZ-së më shumë kohë

që të merret me organizimin e zgjedhjeve. Mirëpo një kërkesë e tillë nuk u morr në konsideratë nga Presidenti.

B. Administrimi i zgjedhjeve

i. Puna e KQZ-së

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në dispozitat ligjore, filloi përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve menjëherë pas shpalljes së tyre nga ana e Presidenti, duke mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme, ku u caktuan afatet kryesore për aktivitetet që janë të ndërlidhura me procesin zgjedhor.⁵

Gjatë periudhës prej ditës shpalljes së zgjedhjeve e deri në ditën e mbajtjes së tyre, KQZ intensifikoi mbledhjet e saj, shpeshherë pa paralajmërim, duke rezultuar me mospjesëmarrje të të gjitha palëve të interesuara.

KQZ-ja fillimisht miratoi buxhetin për organizimin dhe menaxhimin e këtyre zgjedhjeve në shumë prej 4,944,900 Euro. Më tutje, KQZ miratoi kufizimin e shpenzimeve për fushatë nga subjektet politike. Shuma maksimale që mund të shpenzohej nga subjektet u caktua në shumën prej 942,573.50 Euro, apo 50 centë për votues të regjistruar.⁶

ii. Funksionimi e KKZ-ve

Ngjashëm sikur edhe në zgjedhjet e kaluara, funksionimi i Komisioneve Komunale Zgjedhore ka mbetur sfidë e menaxhimit dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor. Kjo sfidë, vjen kryesisht si rezultat i mosmbajtjes së mbledhjeve të rregullta, mungesës së informimit publik dhe procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura. Shumica e parregullsive të lartpërmendura, janë të ndërlidhura me mungesën e mbikëqyrjes së KKZ-ve nga ana e Sekretariatit të KQZ-së, sidomos rreth organizimit dhe mbarëvajtjes së mbledhjeve të KKZ-ve.

iii. Trajnimi i KVV-ve

Sikurse në zgjedhjet e kaluara edhe në këto zgjedhje, Demokracia në Veprim i ka kushtuar rëndësi të veçantë monitorimit të trajnimeve të komisionerëve zgjedhor. Vëzhguesit afatgjatë të Demokracisë në Veprim kanë monitoruar një numër të konsiderueshëm të trajnimeve të zyrtarëve të KVV-ve. Sfiduese për monitorimin e trajnimeve ka qenë mungesa e orarit të trajnimeve, gjë që ka ndodhur në shumë komuna. Nga trajnimet e monitoruara nga vëzhguesit e DnV-së, në krahasim me zgjedhjet e kaluara, është vërejtur një seriozitet më i madh si në organizim, po ashtu edhe në pjesëmarrje të komisionerëve të partive politike në trajnime. Megjithatë, ende ka shumë punë që të bëhet, si në aspektin e organizimit të trajnimeve, po ashtu edhe kualifikimet e komisionerëve. Natyrisht që në këtë aspekt duhet një angazhim i të gjithë akterëve, e sidomos i partive politike të cilat i emërojnë anëtarët e tyre në KVV.

⁵ "Vendim për Caktimin e Afateve të Aktiviteteve Zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme" i marrë më 11 maj 2017. KQZ: Prishtinë.

I qasshëm në: http://kqz-ks.org/Uploads/Documents/vendim%20per%20caktimin%20e%20afateve_accdhsdawl.pdf

⁶ "Vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike" i marrë më 15 maj 2017. KQZ: Prishtinë.

I qasshëm në: http://kqz-ks.org/Uploads/Documents/Vendim%20Kufizimi%20i%20Shpenzimeve-2017_qtlhvdngqc.pdf

iv. Edukimi dhe informimi i votuesve

Numri i lartë i votave të pavlefshme përbën një indikator të qartë se informimi i publikut për procesin zgjedhor, në veçanti për procedurat e votimit nuk ka qenë në nivelin e duhur. Përpos arsyeve teknike, çalimit në informimin e duhur dhe të shënjestëruar të publikut i ka kontribuar periudha e shkurtër për informimin dhe edukimin e votuesve, sidomos për votuesve të rinj.

KQZ-ja nëpërmjet procedurës së tenderimit, ka përzgjedhur një kompani të jashtme për të menaxhuar me komponentën e informimit dhe edukimit të votuesve. Sikur edhe në zgjedhjet e kaluara, KQZ-ja ka shfaqur spote televizive në transmetuesin publik dhe mediat tjera.

Karakteristikë e këtij procesi ka qenë edhe informimi i votuesve të cilëve u është ndërruar Qendra e Votimit. Duke qenë se ka pasur numër të madh të ankesave për ndërrimin e Qendrës së Votimit, KQZ ka zhvilluar informim duke vendosur lista me emrat e personave në Qendrat e Votimit, rreth një javë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

V. CERTIFIKIMI I LISTËS SË VOTUESVE

Në bazë të afateve të caktuara nga KQZ-ja, 1 qershori është caktuar si datë për certifikimin e listës së votuesve. Lista përfundimtare e votuesve, e certifikuar nga KQZ, përbëhej nga gjithsej 1,872,941 votues apo 70 mijë votues më shumë sesa në zgjedhjet e vitit 2014. Nga kjo listë këtë vit janë larguar rreth 30 mijë persona të vdekur. Sidoqoftë, në bazë të deklarimeve të shumta, numri i personave të vdekur në listën e votuesve, mbetet shqetësues.

Votues të rinj, që kanë arritur moshën 18 vjeç, prej zgjedhjeve të vitit 2014, dhe do të votojnë për herë të parë në këto zgjedhje, në listën përfundimtare të votuesve janë gjithsej 118,448 persona. Kurse, 36,754 votues tjerë janë regjistruar për herë të parë në Regjistrin Civil, shumica e të cilëve janë pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës, pas zgjedhjeve të vitit 2014.

Numri i Qendrave të Votimit në këto zgjedhje ka qenë 889 (91 Qendra të Votimit më shumë se në vitin 2014), me gjithsej 2,490 Vendvotime (116 Vendvotime më shumë se në vitin 2014).

VI. VOTIMI NGA JASHTË

Votimi nga jashtë është cilësuar si një nga problemet kryesore të këtyre zgjedhjeve. Këtë vit, numri i qytetarëve të interesuar për votim nga jashtë ka qenë tejet i lartë. Mekanizmat e vënë në dispozicion nga KQZ-ja për regjistrimin e këtyre votuesve ishin votimi përmes postës elektronike, postës dhe faksit. Megjithatë, për shkak të numrit të madh të kërkesave për regjistrim si votues nga jashtë, në ditën e fundit të caktuar nga KQZ-ja për regjistrim, posta elektronike e vënë në dispozicion nga KQZ-ja, që ishte forma më e përdorur për regjistrim, u ballafaqua me probleme teknike, për shkak të mbushjes së kësaj llogarie me shumë kërkesa.

Në bazë të të dhënave të ofruara nga Sekretariati i KQZ-së, për regjistrim jashtë Kosovës kanë aplikuar 20,354 persona, prej të cilëve KQZ ka miratuar 15,118 dhe ka refuzuar 5,236 që ndërlidheshin me mungesën e dëshmive për të vërtetuar të drejtën e tyre për të votuar. Të drejtën e votës nga jashtë e kanë ushtruar mbi 5 mijë persona.

VII. REGJISTRIMI DHE CERTIFIKIMI I KANDIDATËVE

Afati i aplikimit për certifikim të subjekteve politike për këto zgjedhje filloi nga data 11 maj dhe përfundoi më 19 maj 2017, që ishte caktuar si afat për dorëzimin e listave fillestare të kandidatëve për deputetë. Kurse, certifikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve është bërë më 23 maj.

Për të marrë pjesë në zgjedhje KQZ ka akredituar 26 subjekte politike të cilat janë përfshirë në fletëvotim, prej të cilave janë 19 parti politike, 5 koalicione dhe 2 iniciativa qytetare. Shorti për renditjen e subjekteve politike në fletëvotim u hodh më 26 maj.

Secili subjekt politik mund të ketë deri në 110 kandidatë për deputetë në listat e veta, apo 10% më shumë se numri i vendeve për të cilat garohet. Në përgjithësi numri i kandidatëve të cilët garuan në zgjedhje ishte 971. PZAP ka pranuar disa apele të kandidatëve të cilët janë deklaruar se janë përfshirë në lista përkundër vullnetit të tyre.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

KQZ ka përcaktuar që fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të jetë dhjetë ditë, duke filluar nga data 31 maj deri më 9 qershor 2017. Heshtja zgjedhore ka qenë një ditë para ditës së votimit, respektivisht më 10 qershor. Vlen të theksohet që subjektet politike kanë zhvilluar aktivitete para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, në mungesë të dispozitave ligjore adekuate të cilat rregullojnë këtë çështje. Burimet e financimit dhe transparencja financiare e subjekteve politike vazhdojnë të mbeten problematike prandaj duhet të zhvillohet mbikëqyrje më e madhe financiare, sidomos respektimin e vendimit për kufizimet që janë përcaktuara nga KQZ për këtë fushatë zgjedhore. Kufizimi i shpenzimeve për subjektet politike të certifikuar ka qenë 50 centë për votues të regjistruar në nivel vendi, apo 942,573.5 euro gjithsej.⁷

Demokracia në Veprim (DnV) ka monitoruar dhjetë ditët e fushatës zgjedhore në nivel vendi me anë të 61 vëzhguesve afatgjatë, të cilët kanë raportuar në baza ditore mbi mbarëvajtjen e fushatës zgjedhore të zhvilluar nga subjektet politike për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 Qershor 2017. Vëzhguesit e DnV kanë monitoruar 655 aktivitete të subjekteve politike në mbarë vendin, shumica e të cilave kanë qenë tubime publike me deri 500 pjesëmarrës. Vetëm 49 aktivitete kanë pasur më shumë se 1,000 pjesëmarrës.

C. Ambienti i fushatës zgjedhore

Fushata zgjedhore është zhvilluar e qetë, me përjashtim të disa komunave me shumicë serbe, përkatësisht komuna e Leposaviqit dhe Graçanicës, në të cilat ishte raportuar për një ambient të tensionuar dhe incidente në mes subjekteve politike serbe të cilat garuan në këto zgjedhje. Gjuha e urrejtjes ka shoqëruar aktivitetet e organizuara nga subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore dhe vëzhguesit tanë kanë raportuar për 30 raste të tilla. Në shumicën e rasteve të monitoruara Policia e Kosovës është përkujdesur për sigurimin e aktiviteteve zgjedhore. Mediat nuk kanë qenë të pranishme

⁷ KQZ, Vendimi për kufizimin e shpenzimeve të fushatës për subjektet politike, vegëza: http://kqz-ks.org/Uploads/Documents/Vendim%20Kufizimi%20i%20Shpenzimeve-2017_qtlhvdngqc.pdf qasur më 20.06.2017

në 56 % të aktiviteteve zgjedhore të monitoruara në nivel vendi, ndërsa në aktivitetet në të cilat kanë marr pjesë nuk janë penguar të raportojnë lirshëm.


D. Shfrytëzimi i resurseve publike dhe pjesëmarrja e shërbyesve civil në aktivitete elektorale

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 2 përcakton parimet themelore, kurse neni 35 përcakton veprimet e ndaluara të shërbyesve publik duke ndaluar rreptësisht përdorimin e burimeve publike dhe personelin e cilitdo institucion në nivel qendror ose lokal me qëllim të mbështetjes së një subjekti politik në zgjedhje.

Pavarësisht kufizimeve të qarta ligjore, fenomeni i përdorimit të resurseve publike ka karakterizuar edhe këtë fushatë zgjedhore. Për 10 ditë, sa ka zgjatur fushata, vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për 96 raste të përdorimit të resurseve publike. Kjo parregullsi është raportuar më së shumti nga aktivitetet e dy koalicionet e mëdha parazgjedhore: koalicioni PAN me 48 raste dhe ai LAA me 32 raste. Nga Lëvizja Vetëvendosje kemi vetëm 3 raste të raportuara, kurse nga partitë e komunitetit serb SRPSKA 6 raste, PKS 1 rast dhe partitë tjera me 6 raste.

Veturat zyrtare kanë qenë resurset publike që janë përdorur më së shpeshti nëpër aktivitete të fushatës zgjedhore nga subjektet politike (gjithsej 57 aktivitete). Nga këto raste të raportuara, PAN dhe LAA prijnë për nga numri i rasteve kur janë përdorur vetura zyrtare me nga 25 raste secila. Nuk ka munguar as prania e shërbyesve civil në aktivitetet e subjekteve politike. Vëzhguesit tanë kanë arritur të evidentojnë 49 raste kur shërbyes civil kanë qenë të pranishëm në fushatë. Edhe në këto raste, dy koalicionet parazgjedhore PAN dhe LAA kanë dominuar me përdorim më të madh të këtyre resurseve, në 31 aktivitete ka qenë PAN dhe në 10 aktivitete të tjera ka qenë LAA. Në 5 raste të tjera është vërejtur përdorim i llojeve të tjera të resurseve publike.

PËRDORIMI I RESURSEVE PUBLIKE TË NDARA SIPAS SUBJEKTEVE POLITIKE



E. Prania e fëmijëve

Republika e Kosovës ende nuk e ka rregulluar kuadrin ligjor rreth pjesëmarrjes së të miturve në fushata zgjedhore. Kjo çështje duhet të adresohet sa më parë me anë të Ligjit për fëmijë. Gjithsesi, përfshirja e fëmijëve në fushata zgjedhore është në kundërshtim me frymën e Konventës për të Drejtat e Fëmijës, 1989. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në Nenin 22 të saj, ka paraparë zbatimin e drejtpërdrejtë të kësaj konvente në Kosovë, duke i dhënë prioritet në rast konflikti ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike.


Përfshirja e fëmijëve ka qenë një dukuri e pranishme edhe gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 11 qershorit. DnV në mënyrë të vazhdueshme ka ngritur shqetësimin rreth kësaj shkeljeje e cila është vënë re në pjesën më të madhe të aktiviteteve zgjedhore të subjekteve politike. Numri total i fëmijëve prezent në aktivitete elektorale ishte 3,653 të evidentuara në 32 % të aktiviteteve të monitoruara nga DnV. Në fushatën elektorale të koalicionit PAN, fëmijët kanë qenë të pranishëm në 33% të aktiviteteve të monitoruara nga vëzhguesit tanë, LAA në 38% të aktiviteteve të monitoruara, LVV në 32% aktivitete, SRPSKA në 8% të aktiviteteve, SLS në 50% të aktiviteteve dhe parti të tjera në 28% aktiviteteve.

F. Pjesëmarrja e grave

Pjesëmarrje e ulët e grave është shënuar edhe në këtë fushatë zgjedhore. Pavarësisht se është vënë re një sensibilizim i shtuar i partive politike për rëndësinë e votës së grave, kjo nuk është përkthyer edhe në pjesëmarrjen të tyre apo në ofrimin e qasjes së barabartë për gratë në garën zgjedhore.


Gjatë aktiviteteve të fushatës zgjedhore është shënuar prani shumë e ulët e grave në aktivitetet e fushatave zgjedhore. Pjesëmarrja e grave në 655 aktivitetet e monitoruara ka qenë vetëm 17%. Përfaqësimi i grave nëpër aktivitetet elektorale të subjekteve politike në bazë të të dhënave tona ka qenë marginal. Në pothuajse gjysmën e aktiviteteve zgjedhore, në 323 aktivitete pjesëmarrja e grave ka qenë më e ulët se 5%. Në një përqindje prej 5-10% të pjesëmarrjes së grave është shënuar në 123 aktivitete. Me pothuajse të njëjtën shifër të aktiviteteve në 102 prej tyre pjesëmarrja e grave ka qenë 10-20%, ndërsa me më shumë se 20% të pjesëmarrjes së grave në fushatë elektorale kanë qenë vetëm 107 aktivitete të të gjitha subjekteve politike. Nëse i analizojmë sipas subjekteve politike, PAN në 147 aktivitete ka pasur më pak se 5% të pjesëmarrjes së grave, LAA në 61 aktivitete, LVV në 53 aktivitete, SRPSKA në 5 aktivitete, parti të tjera në 57 aktivitete. Me 5-10% të pjesëmarrjes së grave PAN ka pasur 50 aktivitete, LAA 39 aktivitete, LVV 17 aktivitete, SRPSKA 9 aktivitete, SLS 2 aktivitete, parti të tjera 6 aktivitete. PAN ka pasur 49 aktivitete me 10-20% të pjesëmarrjes së grave, LAA 26 aktivitete, LVV 22 aktivitete, SRPSKA 3 aktivitete, dhe parti të tjera 2 aktivitete. Në 35 aktivitete të PAN pjesëmarrja e grave ka qenë më shumë se 20%, LAA në 37 aktivitete, LVV në 11 aktivitete, SRPSKA në 9 aktivitete, PKS në 1 aktivitet, dhe parti të tjera në 14 aktivitete.

PJESËMARRJA E GRAVE NË FUSHATË ZGJEDHORE



Përveç pranisë tejet të ulët të grave në fushatë, gjithashtu është evidentuar përqindje e ulët e grave folëse në këto aktivitete, përkatësisht vetëm 18% e folësve kanë qenë gra. Sa i përket folësve në bazë të gjinisë sipas subjekteve politike shohim se PAN nga 1,081 folës sa ka pasur gjithsej vetëm 209 prej tyre kanë qenë gra ose shprehur në përqindje 19 %, LAA nga 756 folës prej tyre vetëm 123 kanë qenë gra apo 16 %, SLS nga 6 folës nuk kanë pasur asnjë grua si folëse, LVV nga 450 folës prej tyre 128 kanë qenë gra ose 28%, SRPSKA nga 133 folës vetëm 19 prej tyre kanë qenë gra apo 14 %, PKS nga 7 folës, tre nga to kanë qenë gra ose 43%, parti të tjera nga 406 folës, prej tyre gra kanë qenë vetëm 37 prej tyre ose 9%.

FOLËSIT/ET NË AKTIVITETETE TË NDARË NË BAZA GJINORE SIPAS SUBJEKTEVE POLITIKE



G. Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara në fushatë

Pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara ka qenë e ulët gjatë aktiviteteve të fushatës zgjedhore. Vetëm 266 persona kanë marr pjesë në 655 aktivitete të monitoruara, ndërsa në 19% të aktiviteteve zgjedhore nuk u është siguruar qasje adekuate për pjesëmarrje të personave me aftësi të kufizuar.

Shikuar në bazë të subjekteve politike, koalicioni LAA ka pasur numër më të madh të aktiviteteve ku të pranishëm kanë qenë persona me aftësi të kufizuara (46 prej tyre), PAN në 31 aktivitete, LVV në 19 aktivitete, SLS në dy aktivitete, SRPSKA në një aktivitet dhe partitë të tjera në 12 aktivitete.

H. Fushata zgjedhore në rrjetet sociale

Përdorimi i rrjeteve sociale për qëllime të fushatës, në krahasim me përvojat nga zgjedhjet e kaluara, ka qenë shumë më i shprehur. DnV ka përcjellur aktivitetin e subjekteve politike dhe koalicioneve në garë, kandidatëve për kryeministër dhe bartësve të listave në rrjetet sociale, përkatësisht profilet e tyre zyrtare në Facebook. Nga të dhënat e monitorimit për dhjetë ditë të fushatës parazgjedhore, është evidentuar se subjekti politik me numrin më të madh të pëlqimeve dhe ndjekësve në faqen zyrtare në rrjetin social Facebook, ka qenë Lëvizja Vetëvendosje (LVV), e cila në ditën e fundit të fushatës parazgjedhore ka arritur numrin prej 280,564 mijë pëlqime dhe 272,160 mijë ndjekës, pasuar nga koalicioni parazgjedhor PAN me gjithsej 139,361 mijë pëlqime dhe 137,624 mijë ndjekës.

Sa i përket numrit të postimeve, subjektet politike të cilat kanë qenë pjesë të koalicionit LAA, kanë bërë më së shumti postime në faqet e tyre zyrtare në Facebook, në krahasim me subjektet tjera. Gjatë fushatës dhjetëditore, koalicioni LAN ka bërë gjithsej 282 postime në rrjetin social Facebook, pasuar nga koalicioni PAN me gjithsej 172 postime.

Nga kandidatët për kryeministër dhe njëkohësisht bartës të listës, Avdullah Hoti ka bërë më së shumti postime (146 postime në profilin e tij zyrtar në Facebook). Hoti është pasuar nga Kadri Veseli me 63 postime dhe Ramush Haradinaj me 62 postime.

Në postimet e tyre, subjektet në fjalë kanë përdorur, përveç qëndrimeve të shkruara, edhe foto dhe video të ndryshme. Më konkretisht, subjektet politike pjesë e koalicionit LAA kanë postuar numër më të madh të fotove në krahasim me subjektet tjera politike, me gjithsej 729 foto të postuara gjatë fushatës. Pasuar nga subjekti politik LVV me gjithsej 594 foto të postuara në faqen e tij zyrtare në Facebook.

Koalicioni LAA prinë edhe me numrin e videove të postuara me gjithsej 119 të tilla, pasuar nga koalicioni PAN me 69 video të postuara. Ndërsa, nga kandidatët dhe bartësit e listave, prinë Avdullah Hoti me gjithsej 44 video të postuara në faqen e tij, pasuar nga Kadri Veseli me 33 video të postuara.

Sa i përket numrit të pëlqimeve, shpërndarjeve dhe komenteve për postimet e bëra, subjekti politik LVV ka marrë numrin më të madh të tyre (190,748 mijë pëlqime, 17,755 mijë shpërndarje dhe 62,822 mijë komente), pasuar nga koalicioni LAA (48,810 mijë pëlqime, 1,241 shpërndarje dhe 983 komente).

IX. DREJTËSIA ZGJEDHORE

a. Ankesat dhe Parashtresat

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme⁸ rregullon mënyrën se si subjektet politike duhet të sillen në kohën e zgjedhjeve. Në mënyrë shumë të qartë ligji përmes Kodit të mirësjelljes,⁹ të integruar brenda tij, ka rregulluar sjelljen e të gjitha subjekteve politike në periudhën e fushatës zgjedhore, gjatë heshtjes zgjedhore dhe në ditën e zgjedhjeve.

Demokracia në Veprim përmes vëzhguesve afatgjatë, përveç monitorimit të fushatës zgjedhore, heshtjes dhe vëzhgimit në ditën e zgjedhjeve, ka monitoruar edhe shkeljet e mundshme të ligjit nga subjektet politike gjatë gjithë procesit.

Që procesi zgjedhor të jetë në përputhje me standardet e përcaktuara vendore dhe ndërkombëtare, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ka paraparë edhe mundësinë që palët për rastet e shkeljeve të ligjit dhe të kodit të etikës t'i drejtohen institucionit të pavarur - Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP). PZAP është institucion i përhershëm dhe i pavarur përgjegjës për të vendosur për ankesat dhe apelet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. PZAP në përbërjen e tij ka 10 gjyqtarë që punojnë në gjykatat vendore dhe emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme.

Çdo parregullsi dhe shkelje e ligjit apo e kodit të etikës që mund të dëshmohet me prova materiale nga palët, duhet t'i drejtohen Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa që të vendos në lidhje me shkeljen e supozuar të ligjit apo rregullave zgjedhore.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme ka paraparë saktësisht se kush ka të drejtë që të paraqes ankesa në PZAP dhe afatet kohore që këto ankesa duhet të dorëzohen dhe shqyrtohen nga PZAP. Të drejtë për të deponuar ankesë në PZAP kanë të gjithë qytetarët me të drejtë vote, përfaqësuesit e subjektit politik, komisionarët e këshillave të vendotimeve dhe vëzhguesit vendor. Ankesa duhet të dorëzohet në formën e shkruar sipas një formulari unik për të gjitha ankesat dhe më pas mund të dërgohet me postë apo duke e dorëzuar personalisht në PZAP. Afati kohor për dorëzimin e një ankese për shkelje të Kodit të mirësjelljes gjatë fushatës zgjedhore në PZAP është 72 orë nga momenti kur supozohet se ka ndodhur shkelja. Nëse ankesat kanë të bëjë me procesin e votimit dhe numërimin, atëherë ligji ka paraparë një afat prej 24 orësh nga momenti i mbylljes së votimit. Afat i njëjtë prej 24 orësh për dorëzim të ankesës është edhe për ankesat në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR). Të gjitha ankesat të cilat i drejtohen PZAP-së duhet të jenë në formë të shkruar duke plotësuar formularin e ankesës me të dhënat mbi ankuesin dhe shkelësin e supozuar si dhe deklaratën në lidhje me shkeljen e supozuar dhe çdo dëshmi e cila e mbështetë atë deklaram (fotografi, video/audio-incizime, dokument relevant, udhëzime të qarta se ku mund të gjenden dëshmitë si dhe çdo gjë tjetër e cila i mbështetë pretendimet e ankesës).

PZAP pasi të pranoi ankesën e arkivon atë duke i dhënë një numër rendor ankesës dhe duke regjistruar datën dhe orën e pranimit të saj. Pas pranimit të anekses caktohet paneli i gjyqtarëve të cilët vendosin mbi ankesën e palës që i është drejtuar. Paneli i gjyqtarëve vepron sipas Ligjit për Zgjedhjet e

⁸ LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS (Gazeta zyrtare: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>).

⁹ KREU V, KODI I MIRËSJELLJES PËR SUBJEKTET POLITIKE, MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT, Neni 31 deri te neni 38.

Përgjithshme dhe sipas Rregullave dhe Procedurave të PZAP-së si dhe rregulloren 01/2012 për kategorizimin e sanksioneve dhe gjobave¹⁰. Me rregulloren 01/2012 përcaktohen sanksionet dhe gjobat që mund të shqiptohen subjekteve politike për shkeljet zgjedhore.

b. Gjatë fushatës zgjedhore

Fushata zgjedhore për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, ka zgjatur 10 ditë, nga data 31 maj deri më 9 qershor 2017. Gjatë kësaj periudhë kohore, PZAP ka pranuar 191 ankesa në lidhje me shkeljet e supozuara nga subjektet politike. Për shkelje të heshtjes zgjedhore, PZAP ka pranuar 88 ankesa, ndërsa për ditën e zgjedhjeve 32 ankesa. Në vendimet e PZAP-së deri më datën 13 qershor 2017 janë parashtruar 18 apele. Shuma e gjobave të shqiptuara nga PZAP deri më 13 qershor 2017 ndaj subjekteve politike ka qenë 336,950.00 euro.

Shumica e ankesave të drejtuara nga palë të ndryshme në PZAP në kohën e fushatës kanë qenë shkelje e kodit të mirësjelljes. Edhe DnV në procesin e monitorimit të fushatës zgjedhore ka gjetur shkelje të Kodit të mirësjelljes nga subjektet politike pjesëmarrëse në fushatë zgjedhore. Monitoruesit afatgjatë në të gjitha komunat e Kosovës kanë vërejtur posterë dhe afishe të ndryshme nga subjektet politike pjesëmarrëse në zgjedhje. DnV ka fotografuar dhe dokumentuar 78 raste të ndryshme të ngjites së posterëve në hapësira publike si: drunj të qytetit, shtylla elektrike, transformatorë të energjisë elektrike, shenja të komunikacionit dhe hapësira të tjera publike.

Demokracia në Veprim për kohën e fushatës zgjedhore nga 78 raste të dokumentuara dhe të fotografuara ka parashtruar 73 ankesa në lidhje me shkeljet e Kodit të mirësjelljes nga subjektet politike. Në 5 ankesa janë të përfshira dy subjekte politike për shkak se posterët e tyre kanë qenë të ngjitura njëra afër tjetrës. Shumica e shkeljeve të dokumentuara dhe të fotografuara nga DnV janë miratuar nga PZAP dhe gjoba në total të shqiptuara nga subjektet politike në ankesat e DnV është në 134,450.00 euro.

Nga raporti i PZAP-së del se, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, ky institucion ka pranuar 88 ankesa për thyerje të heshtjes zgjedhore nga subjektet politike apo kandidatët për deputetë. DnV përkundër faktit se ka monitoruar edhe ditën e heshtjes zgjedhore, nuk ka gjetur ndonjë shkelje për të parashtruar ankesë në PZAP.

c. Për procesin e votimit dhe numërimit

Për ditën e votimit, subjektet politike por edhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare mund të angazhojnë vëzhgues për vëzhgimin e procesit të zgjedhjeve.¹¹ Ligji ka rregulluar në mënyrë shumë të qartë të drejtat dhe detyrimet që ka secili vëzhgues i cilido subjekt që ai përfaqëson. Fillimisht kërkohet që të gjithë vëzhguesit e ditës së zgjedhjeve dhe procesit të numërimit të jenë të akredituar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Për procesin e votimit dhe për cenimin e këtij procesi, Kodi Penal i Kosovës ka paraparë vepra penale në lidhje me zgjedhjet dhe të drejtën e votimit.¹² Veprat penale që mund të kryhen gjatë procesit

¹⁰ E qasshme në: http://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/09/Rregullen_Nr.01-2012_Per_Kategorizimin_e_Sanksioneve_dhe_Gjobave.pdf

¹¹ LIGJI NR. 03/L-073 PËR ZGJEDHJET E PËRGIJTHSHME NË REPUBLIKËN E KOSOVËS (Gazeta zyrtare: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>), Neni 54 I ligjit.

¹² KAPITULLI XVIII VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE TË VOTIMIT, nga neni 210 deri te neni 220.

zgjedhor por edhe në ditën e zgjedhjeve janë: cenimi i së drejtës për të kandiduar¹³, kanosja e kandidatit¹⁴, parandalimi i ushtrimit të së drejtës për të votuar¹⁵, cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve¹⁶, keqpërdorimi i detyrës zyrtare gjatë zgjedhjeve¹⁷, dhënia ose marrja e ryshfetit në lidhje me votimin¹⁸, keqpërdorimi i së drejtës së votimit¹⁹, pengimi i procesit të votimit²⁰, cenimi i fshehtësisë së votimit²¹, falsifikimi i rezultateve të votimit²² dhe asgjësimi i dokumenteve të votimit²³. Për secilën nga këto vepra pos dënimit me gjobë parashihet edhe dënimi me burg për kryesit e tyre. Dënimet me burg shkojnë nga një deri në pesë vite burgim, varësisht nga forma dhe mënyra e kryerjes së veprës penale.

Në ditën e zgjedhjeve, DnV ka angazhuar nga një vëzhgues në secilin vendvotim në gjithë territorin e Kosovës. Vëzhguesit nga terreni në çdo kohë kanë raportuar mbi të gjeturat e tyre në monitorim. DnV, nga raportet e pranuar, ka dërguar dy ankesa në PZAP për material propagandistik të vendosur në më pak se 100 metra në largësi të vendvotimit. Të dy ankesat janë refuzuar nga PZAP për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme.

DnV, në përgjithësi ka vërejtur reagim të menjëhershëm të organeve përgjegjëse për administrim të zgjedhjeve (përfshirë edhe Prokurorinë e Shtetit) sa herë që janë raportuar parregullsitë e natyrave të ndryshme. PZAP për ditën e zgjedhjeve ka pranuar 32 ankesa nga subjekte të ndryshme në lidhje me shkeljet gjatë ditës së zgjedhjeve.

Edhe Prokuroria e Shtetit së bashku me Policinë dhe Gjykatat në ditën e zgjedhjeve kanë qenë aktive në gjithë territorin. Prokuroria e Shtetit zyrtarisht njofton se ka procedura 13 persona në 12 kallëzime penale, me dyshimin se të njëjtit kanë kryer vepra penale kundër të drejtës së votës dhe vepra penale që ndërlidhen me procesin zgjedhor. Nga të gjitha rastet Prokuroria ka ngritur katër aktakuza ndërsa Gjykatat kanë vepruar duke shqiptuar tre aktgjykime dënuese.

X. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Afati i fundit për akreditimin e organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe vëzhguesve ka qenë data 4 qershor. Me rekomandim të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim (ZRPP), KQZ-ja ka akredituar gjithsej 29,264 vëzhgues për këto zgjedhje. Numri i përgjithshëm i vëzhguesve të akredituar përfshin edhe 160 vëzhgues nga 8 misione diplomatike që veprojnë në Kosovë, 301 vëzhgues nga 7 organizata ndërkombëtare, 27 vëzhgues nga institucione ndërkombëtare, 8 mijë e 830 vëzhgues nga OJQ vendore, 3 mijë e 657 vëzhgues nga partitë politike pjesëmarrëse në këto zgjedhje, 15 mijë e 784 vëzhgues nga Koalicionet pjesëmarrëse në këto zgjedhje, 1 vëzhgues nga 1 institucion

¹³ Neni 210.

¹⁴ Neni 211 i KPK-së.

¹⁵ Neni 212 i KPK-së.

¹⁶ Neni 213 i KPK-së.

¹⁷ Neni 214 i KPK-së.

¹⁸ Neni 215 i KPK-së.

¹⁹ Neni 216 i KPK-së.

²⁰ Neni 217 i KPK-së.

²¹ Neni 218 i KPK-së.

²² Neni 219 i KPK-së.

²³ Neni 220 i KPK-së.

vendor (KPM-ja), 468 vëzhgues të akredituar që përfaqësojnë media vendore dhe 36 vëzhgues të akredituar që përfaqësojnë media ndërkombëtare.

Procesi i akreditimit është përcjellë me disa parregullsi. Duhet përmendur rasti i akreditimit të vëzhguesve të një organizate të shoqërisë civile ta panjohur për publikun. Para mbylljes së afatit të akreditimit të vëzhguesve, me rekomandim të ZRPP-së, KQZ-ja ka certifikuar Institutin Rajonal për Demokraci të Drejta të Njeriut dhe Studime Politike, i cili nuk është tatimpagues aktiv dhe nuk është i njohur për vëzhgim të procesit zgjedhor në të kaluarën. Numri i vëzhguesve të akredituar nga kjo OJQ ka qenë 4,548, e që ka ngritur reagime për shkak se KQZ ka akredituar si vëzhgues persona të cilët dyshohet se janë të afërt me subjekte politike në garë zgjedhore.²⁴

Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për prani të vëzhguesve ndërkombëtar të zgjedhjeve në 454 vendvotime, apo shprehur në përqindje në 18.23% të tyre. Prania e vëzhguesve ndërkombëtar, sidomos e Misionit të Bashkimit Evropian (EU EOM) por edhe e misioneve tjera diplomatike në Kosovë, i kanë kontribuar pozitivisht procesit të zgjedhjeve duke rritur besimin e votuesve në zgjedhje dhe duke detektuar të metat e sistemit të administrimit të zgjedhjeve. Veçanërisht duhet theksuar rolin e EU EOM në vëzhgimin intensiv të punës në Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve (QNR). Përveç kësaj, aspekt tjetër pozitiv është edhe prania e mediave dhe raportimi i tyre më kohë lidhur me parregullsitë e mundshme, që ka bërë të ketë intervenim të menjëhershëm nga organet që merren me drejtësinë zgjedhore. Prania e mediave është evidentuar në 364 vendvotime, apo në 14.62% të tyre.

XI. VOTIMI

Në ditën e zgjedhjeve, DnV ka qenë e pranishme në të gjitha vendvotimet e hapura në Kosovë. Në përgjithësi, procesi ka qenë i qetë ndonëse janë shënuar disa parregullsi, të cilat nuk kanë qenë shkelje të rënda dhe të incidente të dhunshme për të ndikuar gjatë votimit dhe numërimit të votave. Procesi i votimit ka rrjedhur normalisht dhe nuk ka pasur ndërprerje si pasojë e incidenteve serioze.

Qasja e personave me aftësi të kufizuara në vendvotime nuk është garantuar në 737 apo 29.6% të vendvotimeve, duke kufizuar kështu të drejtën e votës për të gjithë qytetarët. Vendosja e vendvotimeve në katet e sipërme të shkollave dhe mungesa e pjerrinave për qasje me karrocë përbëjnë pengesat kryesore në këtë drejtim. Në këto zgjedhje KQZ ka mundësuar që personat e verbër ose me shikim të kufizuar të kenë mundësi të votojnë në mënyrë të pavarur, duke i pajisur vendvotimet me shabllonin në alfabetin e *Brajlit*.

A. Hapja e vendvotimeve

Ligji për zgjedhjet e përgjithshme, Neni 88 pika 1, ka përcaktuar që hapja e Qendrave të Votimit të bëhet në ora 7:00 dhe mbyllja në ora 19:00, nëse nuk ka persona duke pritur në radhë për të votuar. Këshillat e Vendvotimeve (KVV) kanë për obligim që të kryejnë të gjitha përgatitjet e nevojshme në mënyrë të procesi i votimit të rrjedh pa probleme.

²⁴ Kallxo.com, "Zyrtarë të AAK dhe PDK: Akreditimet në emër të OJQ-së i morëm në parti", qasur më 4 korrik, 2017: <http://kallxo.com/zyrtare-te-aak-dhe-pdk-akreditimet-ne-emer-te-ojq-se-morem-ne-parti/>

Vonesat në hapjen e vendvotimeve nuk shkaktuan probleme serioze, megjithëkëtë kishte vonesa në intervale kohor prej 5 deri në 15 minuta në 331 sosh (13.3% të të gjitha vendvotimeve). Vonesat kryesisht kanë ardhur si pasojë e vonesës së komisionerëve apo mungesë së materialeve të nevojshme. Një vendvotim në Komunën e Prizrenit nuk është hapur fare gjatë gjithë ditës së votimit, për shkak të gjendjes jo të mirë të ndërtesës ku është caktuar vendvotimi. Vonesa më serioze konsiderohen ato në kohëzgjatje prej më shumë se 15 minuta e që në këto zgjedhje janë regjistruar në 49 vendvotime. Më së shumti vonesa ka pasur në komunën e Prizrenit, (25 raste), pastaj në Ferizaj dhe Gjilan (nga 4 raste), në Mitrovicë (3 raste), në Prishtinë, Pejë dhe Drenas (nga 2 raste), dhe me nga një vendvotim të hapur me vonesë mbi 15 minuta në Gjakovë, Kamenicë, Klinë, Leposaviq, Malishevë, Shtime dhe Viti.

HAPJA E VENDVOTIMEVE




B. Fushata në ditën e zgjedhjeve

Prania e materialeve propaganduese jashtë Qendrave të Votimit

Zhvillimi i fushatës zgjedhore në vendvotime është i ndaluar dhe përfshin edhe vendosjen e materialeve propaganduese në vendvotime apo jashtë qendrës së votimit në afërsi prej 100 metra.²⁵ Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar për vendosje të materialeve të fushatës zgjedhore në afërsi prej 100 metra të Qendrës së Votimit në 148 raste apo në 5.9%. Të zbërthyer në komuna, janë si në vijim: Prishtinë 17 raste, Prizren 15 raste, Gjakovë 11 raste, Podujevë 10 raste, Deçan, Ferizaj, Gjilan nga 9 raste, kurse në 24 komuna të tjera kanë qenë 68 raste.

²⁵ Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Neni 36 pika, 1.


MATERIALET PROPAGANDUESE NË AFËRSI PREJ 100 m



Propaganda politike brenda Vendvotimit

Propaganda politike brenda vendvotimeve është evidentuar në 80 prej tyre, apo 3.21%. Këtu përfshihen rastet si lejimi i votuesve në vendvotim me simbole të subjekteve politike, promovimi i subjekteve politike gojarisht përmes komisionerëve apo vëzhguesve si dhe për prani të materialeve propaganduese brenda perimetrit të ndaluar. Komunitet në të cilat ka pasur më së shumti propagandë politike brenda vendvotimeve janë: Ferizaj dhe Prishtinë (në 9 vendvotime), Suharekë (8 vendvotime), Deçan dhe Gjakovë (6 vendvotime).

PROPAGANDË POLITIKE BRENDA VENDVOTIMEVE



C. Zbatimi i procedurave të votimit

Zbatimi i procedurave të votimit nga anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve (KVV) është jetike për të garantuar proces zgjedhor të rregullt dhe për të evituar mundësitë e manipulimeve. Këto procedura përfshijnë kontrollimin e votuesve me llambë ultra-violet për të verifikuar nëse votuesi ka votuar paraprakisht, identifikimin e votuesve në listën e votuesve përmes dokumenteve të identifikimit, spërkatjen me prej të gishtërinjve të votuesve, si dhe vulosjen e fletëvotimeve për të vërtetuar origjinalitetin e fletëvotimit.

Vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar në përgjithësi për respektim rigoroz të këtyre procedurave në 98.8% të rasteve. Raste më të shpeshta kur nuk janë respektuar këto procedura janë evidentuar me

rastin e vulosjes së fletëvotimeve (1.53% të vendvotimeve), identifikimin e votuesve përmes dokumenteve, kontrollimin me llambë ultra-violetë (1% të vendvotimeve) dhe spërkatjen e gishtit me sprej (0.92% të vendvotimeve).


D. Fshehtësia e votës

Votimi në grup (familjar)

Fshehtësia e votës është një prej standardeve të zgjedhjeve që duhet plotësuar, ngase u mundëson votuesve të hedhin votën e tyre në pavarësi të plotë. Mbrojtja e fshehtësisë së votës e bën kërcënimin ose ryshfetin shumë më pak efektiv.

Votimi në grup ose i njohur ndryshe edhe si votim familjar ndodh atëherë kur disa persona, shpeshherë me justifikimin e afërsisë familjare, votojnë në të njëjtën kabinë të votimit njëkohësisht. Kjo dukuri ka qenë më e shpeshta në zgjedhjet e 11 qershorit dhe është raportuar në 845 vendvotime apo 33.94% të vendvotimeve në nivel vendi. Shifrat janë pothuajse të ngjashme me zgjedhjet e vitit 2014. Të zbërthyer sipas komunave, prinë komuna e Prishtinës, e pasuar nga Prizreni, Ferizaj, Gjakova dhe Peja.

VOTIMI NË GRUP (FAMILJAR)




Asistenca e votuesve

Asistimi i votuesve të cilët kanë nevojë për ndihmë për të votuar është i lejuar, por që nuk mund të bëhet më shumë se një herë nga i njëjti person, i cili paraprakisht duhet të regjistrohet në librin e votimit. Numri i rasteve kur i njëjti person ka asistuar më shumë se një herë është 424, shifër kjo e lartë dhe vepër e sanksionuar. Në mungesë të trajnimeve adekuate të kryesuesve të këshillave të vendvotimeve, ka pasur raste kur i njëjti ka kërkuar nga vëzhguesit e subjekteve politike të asistojë votuesit. Nga raportimet e vëzhguesve tanë gjatë ditë së zgjedhjeve janë evidentuar 31,477 votime me asistencë në mënyrë të rregullt, që janë regjistruar në Librin e Votuesve. Kjo përbën 4.21% e të gjithë votuesve që kanë votuar në ditën e zgjedhjeve e që krahasuar me zgjedhjet parlamentare të

vitit 2014 kur ishin evidentuar 40,561 raste, ky numër është më i ulët për 9,084. Dukuritë e votimit me asistencë janë hasur në 716 vendvotime, apo shprehur në përqindje në 28.76% të vendvotimeve në tërë territorin e Kosovës.

Të ndara sipas komunave, votime me asistencë ka pasur më së shumti në komunën e Gjilanit (2,169 raste), Ferizajit (2,114), Prishtinës (1,899), Prizrenit (1782) dhe Pejës (1,711).


VOTIMI ME ASISTENCË



Fotografimi i fletëvotimit

Fotografimi i fletëvotimit ka përcjellë edhe këtë proces zgjedhor, madje është evidentuar më shumë se në krahasim me zgjedhjet e kaluara 2014. Vëzhguesit tanë kanë arritur që të evidentojnë 166 raste të fotografimit të fletëvotimit, apo pesë herë më shumë se në zgjedhjet e fundit (33 raste). Shprehur në përqindje, fotografimi i fletëvotimit është hasur në 6.671% të të gjitha vendvotimeve.


VENDVOTIMET KU ËSHTË HASUR FOTOGRAFIMI I FLETËVOTIMEVE



Policia ka bërë edhe ndalime në rastet të cilat janë raportuar për fotografim të fletëvotimit. Për shumicën e rasteve nuk është arritur të dëshmohet se kanë pasur të bëjnë me krijimin e varësisë

ekonomike ndaj votuesve, për çka të njëjtit janë liruar. Fotografimi i fletëvotimit me qëllim të marrjes së ryshfetit në lidhje me votimin është vepër e sanksionuar në bazë të nenit 215 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Komunitet me numrin më të madh të rasteve të fotografimit të fletëvotimit janë: Prishtina (27 vendvotime), Prizren (18), Gjilan (16) dhe Pejë (9). Ndërsa, komunitet në të cilat nuk është raportuar për raste të fotografimit të fletëvotimit janë në: Partesh, Ranilluk, Hani i Elezit, Junik, Kaçanik, Klllokot, Leposaviq, Shtime, Zubin Potok dhe Zveçan.

FOTOGRAFIMI I FLETËVOTIMIT




Votimi jashtë kabinave të votimit

Votimi jashtë kabinave të votimit është një tjetër aspekt që cenon fshehtësinë e votimit, por që në këtë rast ndodh vullnetshëm nga ana e votuesit. Votimi jashtë kabinës së votimit apo votimi i hapur mund të interpretohet edhe si shprehje e lojalitetit ndaj subjektit politik që buron nga frika apo kërcënimi për të votuar në mënyrë të caktuar. Nga të gjitha 2,490 vendvotimet e hapura në vend, vëzhguesit e DnV-së kanë raportuar se në 48 prej tyre ka pasur votime jashtë kabinave të votimit, që shprehur në përqindje i bie që kjo dukuri është manifestuar në 1.93% të tyre.

VOTIMI JASHTË KABINAVE TË VOTIMIT

* sipas vendvotimeve



E. Tentimi për të votuar më shumë se njëherë dhe votimet e dyfishta

Tentimet për të votuar më shumë se njëherë janë evidentuar në 176 raste në 68 vendvotime të ndryshme (2.73% e të gjitha vendvotimeve të hapura në Kosovë). Përkundër këtij numri të tentimeve për të votuar më shumë se një herë ata nuk janë lejuar të votojnë nga ana e komisionerëve. Përjashtimisht 13 rasteve të cilët përkundër gjurmëve të sprejit janë lejuar të votojnë sepse nuk kanë qenë të nënshkruar në listën e votuesve si dëshmi se kanë ushtruar më herët të drejtën e votimit. Komunitat në të cilat kanë ndodhur këto raste janë: Skenderaj (3 raste), Gjilan (2 raste), Mitrovicë e Veriut, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë, Prizren, Shtime, Novobërdë dhe Dragash (nga 1 rast).

Po ashtu, vëzhguesit tanë kanë raportuar edhe për rastet kur votuesit kanë futur më shumë se një fletëvotim në kutinë e votimit. Vëzhguesit nuk kanë mundur të identifikojnë nëse dy fletëvotime janë dhënë qëllimshëm nga anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve apo votuesit kanë sjellë kopje e tyre nga jashtë. Këto janë raste të izoluar dhe numri i tyre është shumë i ulët. 5 raste të tilla janë raportuar në komunitat si në vijim: Mamushe (2 raste), Ferizaj, Kamenicë dhe Skenderaj (nga një rast). Vlerësohet se këto raste mund të kenë ardhur me iniciativë të vetë votuesve dhe kemi të bëjmë me ndonjë skemë të organizuar.

F. Parregullsi tjera gjatë votimit

Numri i madh i vëzhguesve të akredituar të OJQ-ve të dyshimta dhe atyre të subjekteve politike ka marrë edhe vëmendjen e institucioneve që janë përkujdesur për sigurinë gjatë ditës së zgjedhjeve. Në dy raste kemi raportuar për një numër të personave të cilët janë paraqitur në mënyrë të rremë kinse përfaqësojnë organizata të shoqërisë civile dhe parti politike. Vlen të theksohet fakti se prokuroria dhe policia kanë pasur rol shumë pozitiv në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor duke vepruar menjëherë dhe me profesionalizëm.

Prania e personave të paautorizuar

Pas hapjes së votimit, vëzhguesi tanë kanë raportuar për një numër të madh të personave të paautorizuar brenda qendrave të votimit apo vendvotimeve, mirëpo ky numër ka rënë në mënyrë të ndjeshme përgjatë pjesës tjetër të ditës në vetëm 25 raste të tilla. Qendrat e votimit janë siguruar nga Policia e Kosovës.

Dhunë apo kërcënime në Vendvotime

Përdorimi i dhunës apo kërcënimeve ndaj votuesve, anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve apo vëzhguesve është raportuar në 20 vendvotime. Komunat ku është raportuar për raste të tilla janë Ferizaj (4 raste), Gjakovë (3 raste), Mitrovicë (2 raste), dhe 11 komuna të tjera (nga 1 rast).

G. Lista e votuesve

Rritja e numrit të qendrave të votimit në këto zgjedhje ka ndikuar që shumë votuesve t'u ndryshohet qendra e votimit për të votuar. Mosinformimi i duhur dhe në kohë i këtyre qytetarëve nga TMZ ka shkaktuar tollovi gjatë ditës së votimit. Në pamundësi për të gjetur emrin në listën e votuesve, shumë votues edhe mund të jenë dekurajuar për të votuar. Ankesa në lidhje me pasaktësinë e listës e votuesve ka pasur edhe për shkak të pranisë së personave të vdekur në të. Në përgjithësi numri i ankesave është raportuar të jetë 2,419.


Problem tjetër në ditën e zgjedhjeve ka qenë edhe tentimi i votuesve për të votuar me dokumente të cilat sipas Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme nuk janë të pranueshme për të votuar. Në përgjithësi, numri i votuesve të cilët nuk janë lejuar të votojnë për shkak të dokumenteve të identifikimit arrin në 865, prej tyre më së shumti janë evidentuar në komunën e Prizrenit 114 votues, Ferizajt 66 votues, Podujevë 59 votues dhe Prishtinë 49 votues.

XII. NUMËRIMI DHE CERTIFIKIMI I REZULTATEVE

H. Procedurat e numërimit

Mbyllja e vendvotimeve nuk është shoqëruar me probleme. Mesatarisht, të gjitha vendvotimet janë mbyllur në ora 19:20, përderisa votuesit që kanë qenë duke pritur në radhë për të votuar pas ora 19:00 janë lejuar të votojnë. Procedurat e numërimit të fletëvotimeve në 95.53% të vendvotimeve kanë filluar ndërmjet orës 19:00 dhe 20:00. Gjatë numërimit është raportuar edhe për prani të personave të paautorizuar në 9 vendvotime. Të ndara sipas komunave, personat e paautorizuar kanë qenë në Pejë në dy vendvotime, në Gjilan në dy vendvotime, ndërsa me nga një vendvotim në Istog, Lipjan, Prizren, Skenderaj dhe Viti.

KOHA E FILLIMIT TË NUMËRIMIT




I. Votat e pavlefshme

Numri i lartë i fletëvotimeve të pavlefshme edhe në këto zgjedhje është shqetësues, veçanërisht kur marrim në konsideratë faktin që ka trend të rritjes së numrit të këtyre fletëvotimeve, përkundër faktit që sistemi zgjedhor ka mbetur i njëjtë. Në zgjedhjet e 11 qershorit u regjistruan 42,554 fletëvotime të pavlefshme, 6,553 fletëvotime ishin futur të zbrazëta në kutitë e votimit nga votuesit, si dhe 1,746 fletëvotime kanë qenë të dëmtuara qëllimshëm nga votuesit. Numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme, përfshirë ato të dëmtuara qëllimshëm dhe pa paqëllim ka shkuar në 50,853 fletëvotime. Të gjeturat e dala nga auditimi fillestar që KQZ ju ka bërë fletëvotimeve të pavlefshme, tregojnë se në 48.26% të rasteve janë shënjuar vetëm kandidatët por nuk është shënjuar subjekti politik, në 39.58% të rasteve tjera është shënjuar më shumë se një subjekt politik, fletëvotime të pavulosura janë evidentuar në 0.19% të rasteve, ndërsa 11.97% e fletëvotimeve tjera kanë qenë të dëmtuara qëllimshëm nga votuesit.

Vëzhguesit e Demokracisë në Veprim kanë dhënë edhe vlerësimet e tyre lidhur me vendimet e Këshillave të Vendvotimeve për shpalljen e fletëvotimeve të pavlefshme. Sipas vlerësimit tonë, këto vendime në 25% të rasteve nuk kanë qenë të drejtë.


FLETËVOTIMET E PAVLEFSHME



XIII. DALJA NË ZGJEDHJE

Në zgjedhjet e 11 qershorit morën pjesë 747,228 votues, apo 19,605 votues më pak se në zgjedhjet e vitit 2014. Jashtë vendvotimeve kanë votuar 32,501 votues, që përfshihen ata me postë, me kusht dhe votuesit me nevoja të veçanta. Numri i pranuar i fletëvotimeve të vlefshme ka qenë 727,986. Pjesëmarrja në votime sipas intervaleve kohore, deri në ora 11:00 ka qenë 8,56%, ndërsa në ora 15:00 është rritur në 27,58%. Pjesëmarrja përfundimtare në zgjedhje, pas mbylljes së të gjitha vendvotimeve ka qenë 41.30%.


DALJA NË ZGJEDHJE



Komunat e banuara me shumicë serbe kanë pasur pjesëmarrjen më të lartë në zgjedhje. Prinë komuna e Zubin Potokut (63.92%), Shtërpca (54.63%), Ranilluk (53.54%), Novobërdë (52.81%), Partesh (52.66%), ndërsa Prishtina (51.74%) përmbyllë gjashtëshen e komunave të cilat kanë shënuar dalje në zgjedhje me mbi gjysmën e votuesve të regjistruar me të drejtë vote. Komunat me daljen më të ulët në zgjedhje ishin: Dragashi (30.10%), Klina (33.01%), Mitrovica e Veriut (33.03%), Gjakova (35.45%), Istog (35.53%).

Si edhe në proceset e kaluara zgjedhore, dalja në zgjedhje në fund të procesit rritet ndjeshëm. Orët e para të ditës së zgjedhjeve u karakterizuan me dalje të ulët, por që trendi i daljes ishte i njëjtë me proceset e kaluara. Deri në mesditë, në ora 12:00 dalja ishte vetëm 11.55% për t'u rritur në pjesën e dytë të ditës. Periudha e pasdites shënon dinamikë më të madhe, ku deri në ora 15:00 votuan 27.75% e votuesve me të dejtë vote, ndërsa kjo shifër është rritur në 37% deri në ora 18:00. Nga ora 15:00 deri në mbyllje të vendvotimeve në ora 19:00 kanë votuar 84.13% e të gjithë votuesve që kanë marrë pjesë në zgjedhje.

DALJA NË ZGJEDHJE NË KOHË TË NDRYSHME



XIV. REKOMANDIMET

Rekomandimi	Institucionet përgjegjëse për zbatim
<ul style="list-style-type: none"> • Edukimi dhe informimi i votuesve lidhur me procedurat e votimit dhe senzibilizimin për pjesëmarrje në zgjedhje duhet të filloj me kohë dhe të jetë i përshtatshëm për grupe specifike të votuesve siç janë gratë, votuesit për herë të parë, komunitetet jo shumicë, personat me aftësi të kufizuar fizike, dëgjimore, pamore dhe mendore etj. • Materialet e kampanjave të edukimit dhe kanalet e komunikimit duhet të jenë më kreative për të tërhequr vëmendjen e publikut. • Shfrytëzimi i rrjeteve sociale dhe formave tjera të marketingut duhet të merret në konsideratë nga KQZ. • Subjektet politike duhet të punojnë me kandidatët e tyre, për t'u sqaruar procedurat e votimit, në mënyrë që mos të japin udhëzime të gabuara tek votuesit. 	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Subjektet Politike dhe kandidatët e tyre</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve duhet t'i nënshtrohen trajnimeve lidhur me detyrat dhe përgjegjësisë e tyre gjatë ditës së zgjedhjeve. • Në anën tjetër, subjektet politike duhet të nominojnë persona të kualifikuar dhe me integritet për anëtarë të KVV-ve. • KQZ duhet të përkujdeset në ofrimin e trajnimeve më cilësore. 	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Subjektet politike</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Komisionet Komunale Zgjedhore duhet të mbajnë takime të rregullta, të jenë transparente dhe të njoftojnë paraprakisht për oraret e mbledhjeve. Shumë prej mbledhjeve të monitoruara kanë qenë takime formale. 	<p>Komisionet Komunale Zgjedhore</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të mirëmbajë një listë të kontakteve të organizatave që merren me vëzhgimin e zgjedhjeve, në mënyrë që të njoftohem me mbledhjet e KQZ-së. Gjatë periudhës zgjedhore, takimet e KQZ mbahen në intervale të ndryshme kohore dhe njoftimet nuk bëhen me kohë në ueb faqen e KQZ-së, duke e 	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</p>

<p>bërë të pamundur monitorimin. Po ashtu, KQZ duhet të ofroj edhe materialet për të cilat diskutohen në mbledhje, në mënyrë që monitorimi të jetë më efektiv.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> Shpërdorimi i votimit me asistencë, duke asistuar më shumë se një herë, apo duke mos i regjistruar në librin e votimit personat që asistojnë është vepër e ndaluar. Anëtarët e KVV-ve nuk duhet të tolerojnë veprime që cenojnë fshehtësinë e votës. Në këtë kategori, hyn edhe votimi në grup apo votimi familjar, që mund të parandalohet nga anëtarët e KVV-ve. 	<p>Anëtarët e Këshillave të Vendvotimeve</p>
<ul style="list-style-type: none"> Subjektet politike në pushtet nuk duhet të abuzojnë me resurset publike duke i përdorur ato për qëllime të fushatës zgjedhore. Shkuarja në tubime me vetura zyrtare është vepër e ndaluar me ligj, ashtu siç është e ndaluar përdorimi i çfarëdo asemi publik për këtë qëllim. 	<p>Subjektet politike Qeveria e Kosovës</p>
<ul style="list-style-type: none"> Shërbyesit civil e kanë të ndaluar pjesëmarrjen në tubime partiake gjatë orarit të tyre të punës. Të njëjtit, duhet të jenë të kujdesshëm që mos të lënë vendet e tyre të punës për të bërë fushatë për subjektet politike të cilat simpatizojnë. 	<p>Subjektet politike Qeveria e Kosovës</p>
<ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e fëmijëve në fushatë është e ndaluar me Konventat ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e fëmijëve. Subjektet politike nuk duhet të përdorin fëmijët për aktivitetet e tyre, njëjtë siç nuk duhet të nxjerrin nxënësit nga orët e tyre të mësimit për të mbushur sallat ku zhvillojnë aktivitetet. 	<p>Subjektet politike</p>
<ul style="list-style-type: none"> Gjatë zhvillimit të aktiviteteve të fushatës zgjedhore dhe prezantimit të programeve, subjektet politike duhet të përkujdesen që ambiente në të cilat organizohet aktiviteti të kanë qasje për personat me aftësi të kufizuara. 	<p>Subjektet politike</p>
<ul style="list-style-type: none"> Pjesëmarrja e grave në trupat e menaxhimit të zgjedhjeve duhet të rritet. Subjektet politike kanë 	<p>Subjektet politike Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</p>

<p>nënshkruar një Deklaratë ku vullnetarisht deklarohen se do të përfaqësohen me të paktën 40% gra. Andaj, zotime e marra duhet të përmbushen në mënyrë që të garantojnë përfaqësim më të drejtë gjinor.</p>	
<ul style="list-style-type: none"> • Financimi i aktiviteteve të fushatës duhet të jetë transparentë, t'i përmbahet kufizimeve të vendosura nga KQZ-ja. Në këtë kufizim duhet të përfshihen edhe shpenzimet individuale të kandidatëve. • Auditimi i shpenzimeve të fushatës duhet të kryhet me kohë. 	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve Subjektet Politike Kuvendi i Kosovës</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Reforma zgjedhore duhet të jetë prioritet i legjislaturës së re të dal nga zgjedhjet, në mënyrë që të adresoj problemet e identifikuara. Ky duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe duhet përfituar nga anëtarësimi i Kosovës në Komisionin e Venecias, duke marrë përvojat e tyre. 	<p>Kuvendi i Kosovës</p>
<ul style="list-style-type: none"> • KQZ duhet të rishikoj dizajnin e fletëvotimit, duke zvogëluar mundësinë e gabimeve nga ana e votuesve që quan në numrin e madh të fletëvotimeve të pavlefshme. Largimi i numrave në pjesën e majtë të fletëvotimit ku renditen subjektet politike, duke lënë vetëm numrat e kandidatëve do të ndihmonte që votuesi të shënjoj në fletëvotim vetëm emrin e subjektit politik dhe numrat e kandidatëve duke mos i ngatërruar me numrat e subjekteve. 	<p>Komisioni Qendror i Zgjedhjeve</p>

SHTOJCA 1: REZULTATET E ZGJEDHJEVE PËR SUBJEKTET POLITIKE

Emri i subjektit politik	Numri i votave	Përqindja	Ulëse
Partia Demokratike e Kosovës Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës Nisma për Kosovën Partia e Drejtësisë Lëvizja për Bashkim	245.646	33,74%	39
Lëvizja VETËVENDOSJE!	200.138	27,49%	32
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS ALEANCA KOSOVA E RE	185.892	25,53%	29
GRAÐANSKA INICIJATIVA SRPSKA LISTA	44.578	6,12%	9
FJALA	7.991	1,10%	0
KOSOVA DEMOKRATIK TÛRK PARTISI	7.852	1,08%	2
KOALICIJA VAKAT	6.444	0,89%	2
NOVA DEMOKRATSKA STRANKA	3.561	0,49%	1
SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA	3.539	0,49%	1
PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TË KOSOVËS	2.424	0,33%	1
PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE	2.415	0,33%	1
JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA	2.369	0,33%	1
PARTIJA KOSOVSKIH SRBA-AKTIVNA GRAÐANSKA INICIJATIVA	2.123	0,29%	0
PARTIA E ASHKALINJËVE PËR INTEGRIM	2.107	0,29%	1
PROGRESIVNA DEMOKRATSKA STRANKA	1.697	0,23%	0
INICIJATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS	1.520	0,21%	0
KOSOVA TÛRK ADALET PARTISI	1.438	0,20%	0
KOALICIJA SDA	1.355	0,19%	0
POKRET ZA GORA	1.020	0,14	0
PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS	955	0,13%	1
KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA	950	0,13%	0
GRAÐANSKA INICIJATIVA GORE	813	0,11%	0
PARTIA DEMOKRATIKE E UNITETIT	478	0,07%	0
GI. ZA PROSPERITET KOSOVA	312	0,04%	0
G I EROMENDJE ALTERNATIVA	244	0,03%	0
NAPREDNA SNAGA KOSOVA	226	0,03%	0

Përkrahur nga:

